



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300900/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** *Rekomandime për inspektimin e bërë në Komisarlatin e Policisë Tepelenë.*

**Drejtuar:** **Z. Ardian ÇIPA**  
**Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë**

**GJIROKASTËR**

**Z. Florian RRASA**  
**Shef i Komisarlatit të Policisë**

**TEPELENË**

**Për dijëni:** **Drejtues Madhor Muhamet RRUMBULLAKU**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit**

**TIRANË**

*Të nderuar,*

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe duke vlerësuar angazhimin dhe punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni, si dhe frymën e mirë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis institucioneve tona, në vijim po ju njohim me inspektimin që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në Komisarlatin e Policisë Tepelenë.

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, seksion pranë Avokatit të Popullit, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë të personit në Komisarlatin e Policisë Tepelenë.

Inspektimi u krye në datën 11.10.2023, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë znj. Gloria Çarkaxhiu dhe znj. Nertila Qafzezi, me detyrë Nd/Komisionere pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, procedurën standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së

*Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, procedurën standarde e punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894, datë 19.07.2022, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

## **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetasit e privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit z. Florian Rrasa i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim të takimit, z. Rrasa informoi grupin e inspektimit, mbi masat e marra për realizimin e rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit referuar inspektimit të mëparshëm, lidhur me përmirësimin e kushteve të ambienteve të shoqërimit të këtij Komisaritati sipas procedurës standarde të ambienteve të shoqërimit të këtij komisaritati.

Grupi i inspektimit, pasi mori informacionin e nevojshëm vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të Komisarariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar të arrestuar apo ndaluar.

Drejtuesi dhe punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tepelenë, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë gjithë inspektimit që u zhvillua ambientet e këtij Komisaritati.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se<sup>1</sup>:

- Ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoi se:

- Nuk është realizuar marrja e masave të nevojshme dhe gjetja e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstruksionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Tepelenë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjitoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë.
- Nuk është realizuar marrja e masave të menjëhershme për rikonstruksionin e ambienteve të shoqërimit të shtetasve të Komisarariatit të Policisë Tepelenë të cilat ishin të amortizuara.

---

<sup>1</sup> *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatin e Policisë Tepelenë Nr.K4/I31-2Prot Dt.25.07.2022.*

- Nuk është realizuar marrja e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për marrjen e masave të menjëhershme për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit për rritjen e higjienës, ndërkohë që nuk ishte realizuar rekomandimi për zëvendësimin e stolave si dhe pajisjeve të tjera për qëndrimin e personave të shoqëruar në këto dhoma.
- Nuk është realizuar marrja e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
- Nuk është realizuar marrja e masave të nevojshme për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarariat.

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se ndërsa disa çështje për tu përmirësuar kanë implikime buxhetore, për disa moszbatimi tregon neglizhencë në garantimin e standardeve ligjore që lidhen me trajtimin e personave të ndaluar e shoqëruar. Nisur nga kushtet aktuale vazhdonin të ishin të pranishme problematikat, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre.**

Sipas informacionit të grumbulluar në vend gjatë kryerjes së inspektimit, **rezultoi se gjendja konkrete e ambienteve të shoqërimit ishte e ngjashme si në inspektimin pararendës**, ballafaquar me standardet e parashikuara në aktet normative dhe dokumentet ndërkombëtare, për respektimin e të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar brenda këtyre ambienteve.

Në Komisarariat e Policisë Tepelenë ambientet e shoqërimit ishin të ndërtuara pjesërisht sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar dhe procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022, ku parashikohet se dhomat e shoqërimit duhet të jenë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim, si dhe të ndara më vete për gratë, meshkujt madhorë dhe të miturit.<sup>2</sup>

Në këtë komisarariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në katin e parë të një ndërtesë brenda territorit të këtij organi, në hyrjen e tij. Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Dyert e dhomave të shoqërimit ishin prej druri, të cilat kishin mundësi për t’u mbyllur nga jashtë. Megjithatë sjellim në vëmendje se në *“pjesën e sipërme të dyerve duhet të krijohet një hapësirë me përmasa 60 x 40 cm, në të cilën montohet një xham transparent dhe i armuar (i pa çmontueshëm dhe rezistent/i pathyeshëm ndaj*

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 4, gërma “c” e procedurës standarde të punës *“Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”* i procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

goditjeve me grushte, shkelma, kokë). Hapësira e dritares/sportelit të derës nga ana e korridorit të dhomave sigurohet me një rrjetë teli me shufra me seksion/trashësi 0,6 mm të cilat vendosen në mënyrë vertikale dhe horizontale duke krijuar kuadrate 5 x 5 cm.”<sup>3</sup>

Dhomat e shoqërimit **nuk ishin të mirëmbajtura**, muret e tyre kishin lagështirë të theksuar dhe nuk kishin kushte të përshtatshme higjieno-sanitare pavarësisht rekomandimeve të përsëritura për këtë çështje në inspektimin e mëparshëm. Ato kishin nevojë për rikonstrukcion pasi ishin të amortizuara. Pajisjet si tavolina dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar nuk ishin në proporcion me numrin e kapacitetit të dhomave, si dhe ishin tejet të dëmtuara. Për këtë problematikë Komisariati i Policisë Tepelenë kishte bërë kërkesa të herë pas herë pas hershme nëpërmjet shkresave drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër “Kërkesë për tërheqje material për nevoja pune”, por ky shqetësim mbetet ende i pazgjidhur.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit kishte një tualet në të cilin kishte ujë të rrjedhshëm por edhe ky ambient paraqitej me lagështirë të theksuar. Bazuar në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 894 datë 19.07.2022 procedura standarde e punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, duhet të ketë tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.<sup>4</sup>

Gjithashtu kishte edhe gjenerator funksional për furnizimin me energji në rast defektesh. Ambientet e shoqërimit nuk kishin sistem ngrohjeje.

Në këtë komisarjat **kishte sistem monitorimi me kamera** për mbajtjen në vëzhgim të korridorit të ambientit të shoqërimit. Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar.

Në Komisarjatin e Policisë Tepelenë, gjatë periudhës 01.04.2023 deri më 11.10.2023 ishin të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar dhe të evidentuar në regjistrin e shoqërimit **43** persona, sipas përcaktimeve të bëra përkatësisht në nenin 109 “Shoqërimi në polici” dhe në paragrafin 1 të nenit 112<sup>5</sup> “Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit” të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar.

---

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 4, gërma “e.6.4” e procedurës standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë” i procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.

<sup>4</sup> Kreu VI pika 4 gërma “e.2” “Pranë dhomave të shoqërimit dhe ngjitur me to ndërtohen dhe funksionojnë tualetet për kryerje të nevojave personale të ndara për femra dhe meshkuj, me sipërfaqe të mjaftueshme për vendosjen e pajisjeve përkatëse dhe funksionimin për qëllimin që kanë, me sipërfaqe 6 – 8 m<sup>2</sup>.”

<sup>5</sup> Paragrafi 1 i nenit 112 parashikon: “Për të regjistruar nga ana administrative të dhënat e personave të shoqëruar, të arrestuar apo të ndaluar, policia kryen këto veprime: 1. Në rast shoqërimi, policia evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për: a) gjenealitetet; b) vendbanimin; c) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta; ç) punën që kryen; d) arsyet e shoqërimit; dh) orën, datën dhe vendin e shoqërimit; e) zyrën e policisë ku është kryer shoqërimi; ë) punonjësin e policisë, i cili ka kryer shoqërimin.”

Mekanizmi Kombëtar kërkon dhënien e kartës së të drejtave në formë shkresore që në momentin e hyrjes në Komisarariat<sup>6</sup> si dhe të plotësohen regjistrat në dinamikë dhe jo në momentin kur largohen personat nga ambientet e Komisarariatit.

Në Komisarariatin e Policisë Tepelenë mungonte dhoma e mbajtjes së provave materiale, në mungesë të saj oficerët e policisë gjyqësore, sendet të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale i mbanin në zyrat e tyre të cilat shërbejnë edhe për intervistimin e personave të shoqëruar/ndaluar.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre.**

Në Komisarariatin e Policisë Tepelenë nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Gjirokastrë.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarariatin e Policisë Delvinë, “*Regjistri i evidentimit të dhënave për personat e shoqëruar*” ishte i tipit “*Model nr. 1*” konform me procedurat standarde miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit procedura standarde e punës “*Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë*”, dhe ishte i sekretuar. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të parashikuara në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se: koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta.<sup>7</sup> Rubrikat e regjistrat ishin plotësuar me saktësi nga punonjësit e policisë të këtij institucioni. Punonjësit e policisë sqaruan se si orar shoqërimi fillestar vendosej momenti i arrestimit/ndalimit në vendin e privimit të lirisë, në çdo rast ky orar shërben dhe në momentin e hyrjes së personave në Komisarariatin e Policisë Tepelenë dhe ky orar shërben edhe në procedurat që ndiqen lidhur me arrestimin e personave kur ekzistojnë kushtet që urdhërohet arrestimi i tyre.

Në këtë komisarariat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i

---

<sup>6</sup> CPT u bën thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmarrin hapa për të siguruar që personat e ndaluar nga policia të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i heqjes së lirisë (domethënë, nga momenti kur ata janë të detyruar të qëndrojnë në polici).

Kjo duhet të sigurohet me dhënien e informacionit të qartë verbal që në fillim, për t'u plotësuar në rastin më të shpejtë (domethënë, menjëherë pas mbërritjes në ambientet e policisë) me sigurimin e fletës së informacionit të lartpërmendur. Personave në fjalë duhet t'u kërkohej të nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se ata kanë marrë një kopje të fletës së informacionit.

Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019) 28 [par.24]. Konsulto: <https://rm.coe.int/168097986b>.

<sup>7</sup> Kreu V i procedurës standarde e punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve që shoqërohen në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894 dt. 19.07. 2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Në këtë Komisariat edhe pse administrohej regjistër për të miturit të shoqëruar në konflikt me ligjin ku evidentoheshin të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente, rezultoi se ky regjistër nuk ishte në formatin e kërkuar pasi në të u konstatua se mungonin një pjesë e konsiderueshme e rubrikave të tij duke sjellë për pasojë mosplotësimin në mënyrë korrekte të këtij regjistri dhe mospërmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore.

Gjithashtu, në këtë Komisariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisarlatin e Policisë Tepelenë oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Gjithashtu Komisarlati i Policisë Tepelenë nuk posedon hapësirë të posaçme për biseda apo intervistim me persona të mitur, MKPT e konsideron me rëndësi të veçantë faktin se bisedat me fëmijët duhet të realizohen në një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët, pasi nga intervistimi i tyre në kushtet aktuale mund të shkaktohet traumatizim plotësues i fëmijëve.

Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit nisur edhe nga inspektimi i mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e zyrave të dedikuara ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto **zyra por është konstatuar se sërish rekomandimi nuk është plotësuar.**

Avokati i Popullit, duke iu referuar standardeve kombëtare e ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale.

## **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Nga pyetja e punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Punonjësit e policisë pasqyruar për grupin e inspektimit se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë.

Ndërsa psikologu sigurohej në bashkëpunim me shkollat e mesme të qytetit të Tepelenës. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tepelenë ishte zhvilluar konform ligjit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij komisaritati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “*Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit*”.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Për sa më sipër dhe me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme dhe gjetjen e fondeve përkatëse për të mundësuar rikonstrukcionin e përgjithshëm të godinës së Komisarariatit të Policisë Tepelenë me qëllim për ta kthyer atë në një institucion me standarde bashkëkohore dhe dinjtoze, si për personat e shoqëruar, arrestuar/ndaluar, ashtu edhe për punonjësit e policisë.

2. Marrjen e masave të menjëhershme për rikonstrukcionin e ambienteve të shoqërimit të shtetasve të Komisarariatit të Policisë Tepelenë të cilat ishin tejet të amortizuara.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për mirëmbajtjen e dhomave të shoqërimit si: rritjen e higjienës, zëvendësimin e stolave si dhe pajisjeve të tjera për qëndrimin e personave të shoqëruar në këto dhoma.
4. Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen e institucionit me një regjistër të ri për evidentimin e të miturve të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.
5. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të përshtatshme ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
6. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrave të posaçme për intervistim me persona të mitur, duke ofruar një ambient të përshtatshëm që duhet të jetë i rregulluar në mënyrë të posaçme për zhvillimin e bisedave me fëmijët.
7. Marrjen e masave të nevojshme për ndërtimin brenda ambienteve të shoqërimit ose ngjitur me to, tualete të ndara më vete për femra dhe meshkuj, të pajisur me mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.
8. Marrjen e masave për zëvendësimin e dyerve të dhomave të shoqërimit duke i përshtatur ato me standardet e parashikuara në procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.894, datë 19.07.2022.
9. Marrjen e masave të menjëhershme për dhënien e kartës së të drejtave në formë shkrese personave të shoqëruar në momentin e hyrjes së tyre në komisarariat.
10. Marrjen e masave për krijimin e dhomës për mbajtjen e provave materiale dhe largimin nga zyrat e punës së oficerëve të policisë gjyqësore të sendeve të cilat mund të ekspozojnë dhunë psikologjike/fizike tek personat me të cilët ata kryejnë veprime procedurale.
11. Marrjen e masave të menjëhershme për nisjen e procedurës për identifikimin e arsyeve për moszbatimin e rekomandimeve në pikat nr. 3, nr. 4 dhe nr. 9 si dhe marrjen e masave disiplinore për personat përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**